

Gani PLLANA, Sadete PLLANA

FJALË POTENCIALE DREJTPËRDREJT PËR TERMA TEKNIKE TEK LEKË MATRËNGA, PJETËR BUDI, FRANG BARDHI DHE PJETËR BOGDANI

Abstrakti: Si objekt me interes të veçantë i këtij punimi është pikërisht vështirimi i fjalëve të zakonshme, qysh nga koha e evidentimit të tyre jo vetëm në tekstet e shkruara, si p.sh. tek veprat e Lekë Matrëngës, Pjetër Budit, Franga Bardhit dhe Pjetër Bogdanit (si gjallues në kohën e vet, i përshtatshëm, i krijuar) etj., si edhe të pasqyruara në fjalorët e shqipes si p.sh. nga Fjalori i Frang Bardhit ku takohen një varg fjalësh, të cilat kanë funksionuar si njësi speciale dhe më vonë kanë kaluar në terma. Nga pikëpamja e zanafillës së krijimit të tij në rrjedhë të kohërave deri në gjendjen e sotme ai mund të vështrohet edhe si formim nga fjalë të zakonshme, si edhe në zhvillimin e tyre të mëtejshëm, si njësi që ndahen në dy grupime të mëdha në vartësi nga dy stadi kalimi të tyre nga format e leksikut special: të ulët deri në formë të leksikut special të lartë, ku si bazë kalimi shërben ngritja e tyre nga një koncept i ulët në atë të lartë. Drejtpërdrejt ato lidhen si me fjalë të zakonshme, ashtu edhe me njësi të një niveli më të lartë konceptor, siç janë termat, të cilët mund t'i quajmë ose njësi speciale të nivelit shkencor-teknik ose njësi të specializuara, meqë lidhen me fusha të veçanta të identifikuar të dijes.

Fjalët kyçe: fjalë të zakonshme nga lashtësia, autorë të vjetër shqiptarë, terma teknike, leksik special.

Hyrje

Lidhur me veçoritë karakteristike të leksikut të nxjerrë nga veprat e Lekë Matrëngës, Pjetër Budit, Frang Bardhit dhe Pjetër Bogdanit, mund të nënvizohet, se të gjitha njësitë kanë shërbyer si fjalë potenciale drejtpërdrejt për terma, të cilat janë realizuar në kohën e formimit të sistemeve terminologjike teknike (kryesisht pas viteve 1912-1920), si, p.sh.: rrotë, fuqi, forcë ose si termelemente që janë futur në përbërje të togfjalëshave terminologjike teknike. Këto të fundit shfaqen në formën e fjalëve mbiemra të zakonshëm, si: i madh, i vogël, i lehtë, i butë, i lartë, i ulët, i thjeshtë: rrotë e madhe (mek.), plug i lehtë (bujq.), tension i lartë (el.) ose edhe si fjalë libnore në përbërje po të togfjalëshave terminologjike: i mprehur, i rrahur (majë e mprehur, hekur i rrahur). Disa prej tyre korrelohen me emra në mikrosisteme fjalëformuese (termformuese) dhe mund të konsiderohen si terma, si: i mprehur dhe mpreh → mprehje, i forcuar dhe forcoj → përforcoj → forcim → përforcim. Ky lloj leksiku i ngritur (libror) karakteristik për çdo terminologji të krijuar shumë kohë më vonë në Shqipëri (vitet 1912-1920) është përftuar nga ballafaqimi me leksikun e një gjuhe të një kulture të lartë për kohën, siç ka qenë gjuha latine (e cila në atë kohë ishte në kulmet e veta si gjuhë e dijes, e filozofisë në mesjetë dhe e teologjisë), që është transplantuar në një gjuhë tjetër me zhvillim sigurisht të ulët, siç ka qenë shqipja. Ndonëse me zhvillim të tillë, ajo doli e aftë t'i përgjigjej këtij transplantimi në tri mënyra: me përkthim të drejtpërdrejtë, me huazime nga gjuha e madhe që shërbente si bazë përkthimi, me përshtatje leksiku (çka lidhej edhe me aftësinë e autorit përkthyes) dhe me

brumin gjuhësor vendës (çka lidhej edhe me aftësinë e gjuhës pritëse, siç është shqipja. Kjo, pra, na mundëson që edhe terminologjinë teknike të sotme, sikurse edhe terminologjitë e tjera shqipe), ti vështrojmë në dritën e këtij leksiku, të ardhur nga lashtësia e hershme mesjetare, të zhvilluar në rrjedhë të kohërave me format e mbetura si të tilla, por me përmbajtje konceptore (në thelb të njëjta apo të përafërta (si: rrotë, fuqi), të modifikuara ose të ndryshuara (të terminologjizuara si: derë, këmbë (kanbë).

Leksiku plotësues i nxjerrë nga vepra e Lekë Matrëngës (1567-1619)

Lekë Matrënga është autori më i vjetër i letërsisë arbëreshe. Mendohet, se, të parët e Lekë Matrëngës janë shpërngulur nga Çamëria ose Peloponezi (Greqi, prej Moresë), gjegjësisht nga Himara (Shqipëri). Rreth vitit 1592 u kthye në vendlindjen e tij, pasi që kishte studiuar në kolegjin fetar të Romës, ku shërbeu si prift ortodoks kryesisht i arbëreshëve të atyshëm të cilët nuk e kuptonin italishten. Në përgjithësi, gjuha e Lekë Matrëngës pasqyron toskërishten e vjetër, me disa veçori fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore. Gjuha e tij është e folmja shqipe/arbëreshe e Horës së Arbëreshëve të shek. XVI. Vepra e Lekë Matrëngës mban titullin “E mbsueme e krishterë...” dhe italisht “Dottrina Christiana” (1592), e cila ka 28 faqe dhe rreth 450 fjalë, e shkruar me alfabetin latin, duke përdorur edhe shkronja të kombinuara për tingujt e gjuhës shqipe, të cilat nuk i ka latinishtja.

Analizë e veçorive kryesore tek vepra e Lekë Matrëngës (Ma/2)¹

1. Si njësi të reja, nga pikëpamja e shfaqjes së tyre si kategori leksikogramatikore dhe fjalëformuese:

pastroj(i pastruar) dhe pastrim(emër foljor) dhe i fuqishëm nga fuqi (tek Bz/1 dhe Ma/2).

2. Fjalë që kanë shërbyer për zëvendësimin e fjalëve të huaja:

pastroj (tek Ma2) dhe purifikoj (tek Buzuku (Bz1)), shpejtoj (tek Ma2) dhe soliqtoj (tek Bz1).

3. Fjalë që kanë shërbyer si gjymtyrë togfjalëshash terminologjike (mbiemra të parmë, të përbërë ose mbiemra prejpjesorë):

i shpejt, i fuqishëm, i vënë, i kryqëzuar, i rrahur, i hipur.

4. Asocime të foljeve me emrat:

dërtoj2(←dërtuarë) shtëpinë1, ngrë2shtëpinë1, shpejtoj2punën1, qëroj2drunë1, ushqej2copën1.

5. Lidhje asociative fjalëformuese:

fuqi → i fuqishëm, pastroj-pastrim (prapashtesat: -shëm (mbiemër)), dhe (emër foljor). Këto lidhje dalin për herë të parë tek Ma/2.

¹ K. Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe II”, BOTIMET TOENA, Tiranë, 1998, f. 53-89.

6. Sinonimizim me leksikun e Buzukut (Bz/1):

i dëlirë¹-i purifikuar¹-i pastruar², i solçituom¹-i shpejtuar².

Leksiku plotësues i nxjerrë nga vepra e Pjetër Budit (1618-1621)

Pjetër Budi ka pasuruar gjuhën shqipe me 2453 fjalë¹, me veprat e botuara: “Doktrina e krishtenë (Dottrina Cristiana)” (1618, 1636, 1664, 1668), “Rituali roman (Rituale Romanum)” (1621), “Kush thotë meshë, këto kafshë i duhet me shelbuam” (1621), “Pasqyra e të rrëfyemit (Speculum Confessionis)” (1621). Ai këmbëngulte që ceremonitë fetare të zhvilloheshin në gjuhën shqipe.

Analizë e veçorive kryesore tek vepra e Pjetër Budit (Bu/3)²

1. Fjalë që kanë shërbyer për zëvendësimin e termave të huaj:

qepër ← kapriatë, mjedis ← ambient, themel³-fundament, i gërryer ← i abroduar, tra ← shtab, hulli ← brazdë, thërrmijë (grimcë) ← korpuskul, qiri ← kandelë, i plogët ← inert, lodh ← fëdig, nxit ← eksitoj, duq ← rubinet.

2. Fjalë që kanë shërbyer si gjymtyrë togfjalëshash terminologjikë (mbiemra të parmë, të përbërë, mbiemra prejpjesorë):

i ashpër(sipërfaqe),i(e) afërt(pikë),i derdhur, i dredhur (fill), i frytë, i ftohtë, i hapët, i hollë, i kulluar, i lidhur, i ndezur, i pafund, i pastër, i plogët, i qitur, i rrallë, i rrjedhur, i shënuar, i thjeshtë (mekanizëm), i trashë, i tretur.

3. Asocime të foljeve me emrat terma:

shkatërroj (lidhjen), shkul (shtyllën), dëmtoj (copën), dërgoj (ajrin), dredh (fillin), fërkoj (sipërfaqen), avulli fluron, gërryej (sipërfaqen), gozhdoj (lidhjen), lëmoj (sipërfaqen), lidh (fillin), mat (madhësinë), mbyll (qarkun), nis (punën), nxeh (ujin), ngroh (vajin), nxit (lëvizjen), pastroj (sipërfaqen), peshoj (sasinë), prish (përzierjen), provoj (fortësinë), pështjell (fillin), rretho j(mjedisin), rrit (peshën), sharroj (hekurin), shënoj (pikët), vaji rrjedh, shkel frenin, shpoj (sipërfaqen), shtrëngo (vidhën), shmang drejtimin, sjell(rrymën), forca vepron, zvogëloj←vogëluam (shpejtësinë),vajoj(sipërfaqen).

4. Valencat e emrave:

arkë(e farës), bërryl(i boshtit), dërrasë(themeli), dhëmb(sfurku), drapër(korrjeje), duq(rubinet (uji), enë (uji), fie(teli), flakë(furre), flori(i pastër), gjurmë(goditje), grykë(pusi), hulli(e thellë),

² J. Kastrati, “Historia e Albanologjisë”, Tiranë, 2000, f. 77.

³ K. Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe II”, BOTIMET TOENA,Tiranë, 1998, f. 164-309.

ijë(anë)(dhëmbi), gëlqere(e shuar), kohë(e shtypjes), kosë(bari), kufi(i shtypjes), kupë(mbyllëse), lak(kapës), lëkurë(e hollë), limë(e ashpër), mjedis(furre), oborr(shtëpie).

5. Vështrimi i fjalëve nga pikëpamja e sinonimisë (Bz/1+Bu/3):

ar1-flori3, bërryl1-gju3, grimcë3-thërrmijë2, solçitoj1-shpejtoj3, purifikoj1-pastroj3, fëdig1-lodh3, fundament1-themel3.

6. Antonime (Bz/1-Bu/3):

i hapët3-i mbyllur3, nxeh3-ngroh3, i hollë3-i trashë3, i ftohtë3-i ngrohtë.

7. Mbiemra të parmë:

i drejtë, i hollë, i madh, i pastër, i pasur, i plogët, i ri, i rrallë, i shpejtë, i thatë, i thellë, i shkurtër, i thjeshtë, i trashë, i turbullt, i vjetër, i varfër, i verbër.

8. Parashtesa:

zbardh, shpërlam, shprish, disgradoj, dveshun (zhvesh).

Leksiku i nxjerrë nga "Dictionarium latino-epiroticum" i Frang Bardhit (1635)

Frang Bardhi është një ndër figurat më të shquara të kulturës sonë kombëtare të shek. XVII. Përpjekjet e para për leksikografinë dhe studimin e strukturës gramatikore të gjuhës shqipe, nga ana e gjuhëtarëve vendas në shek. XVII, nisin me Frang Bardhin (1635). Me fjalorin e tij, latinisht-shqip¹, nis tradita leksikografike shqiptare. Fjalorin e shkroi me qëllim që t'i vinte në ndihmë gjuhës sonë, që ishte rrezik të humbte me të kaluarën e kohës. Për herë të parë shqipja vihej ballë për ballë, në një rrafsh tërësor e të kodifikuar leksikor, me latinishten, gjuhën më të përpunuar ndërkombëtare të asaj kohe.

Fjalori ka 5.000 fjalë latine dhe 2544 fjalë shqipe. Autori disa fjalë të latinishtes i ka përkthyer me një fjalë të vetme shqipe ose përdor mënyrë përkthimi perifrastik (mendohet që si fjalë autoktone të jenë gjysma e numrit 2544, pra rreth 1300 fjalë; duke hequr huazimet greke, latine, turke e sllave).

⁴ F. Bardhi, "DICTIONARIUM LATINO EPIROTICUM", Romae, 1635.

Analiza e veçorive të leksikut tek vepra e Frang Bardhit (Ba/4)¹

1. Zëvendësimi i termave të huaj:

ballë → front, çast → moment, gisht ← spinot, gurrë → burim, kunorë → koronë, lëkundës-i → oshilator, majth → çekiç, mjedis → ambient, skaj → ekstrem, themel → funament, thjerr → lentë, timetar → oxhak.

2. Mikrosisteme fjalëformuese:

rreth-rrethim, mbjellje-mbjellës, ftohje-ftohëse, nxehtësi-të nxehtit, peshojë-peshor, shpejtim-shpejtues-i.

3. Ndërtime prapashtesore:

-es: dëlirëdhëmbes, fikes-i, lëkundes, mbjelles-i, nxites, kthyes, shpejtues-i, shkumues-i, shënjues-i, turbullues-i.

-ojë: mbulojë, peshojë.

-or: peshor, rëror, nyjor, hekuror.

-tar: timëtar,

-ëri: papërshtatshmëri,

-ësh (ojsh): trekondojsh, shumëkëndsh, tredhëmbësh.

-ësi: nxehtësi, hollësi, ftohtësi, rrallësi, gjerësi, lagështi.

-im/je: ushqim, rrethim, kthim, shpejtim, rrezatim, kërcim.

-je: mbjellje, përzierje, mbajtje, ftohje, gjetje.

-esë: pengesë.

4. Ndërtime kompozimore:

delirëdhëmbës-i, tredhëmbësh, shumëkëndësh, trekondojsh.

Leksiku i nxjerrë nga “Çeta e profetëve (Cuneus Prophetarum)” i Pjetër Bogdanit (1662-1689)

Vepra e Pjetër Bogdanit ka një rëndësi të veçantë gjuhësore me materialin që sjell për gramatikën historike të shqipes², sidomos me visarin leksikor të saj. Bogdani krijoi fjalë të reja për konceptet që i duhet të shprehë.

Qëllimi i veprës “Çeta e profetëve (Cuneus prophetarum)” e botuar më 1685 në Padovë, u rishtyp më 1691 dhe 1702 në Venedik me titull të ndryshëm, ishte arsimimi i popullit, krijimi i fondit të fjalorit të terminologjisë në përkatësi me fushat ose lëndët. Libri “Cuneus Prophetarum”, apo sipas përkthimit të Justin Rrotës “Çeta e profetëve”, është një nga veprat më të rëndësishme të trashëgimisë letrare shqiptare. Është e para vepër origjinale në gjuhën shqipe,

⁵ K. Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe III”, Shkodër, 2000, f. 91-295.

⁶ J. Kastrati, “Historia e Albanologjisë”, Tiranë, 2000, f. 108.

në krahasim me veprat e autorëve paraardhës që ishin kryesisht përkthime, e bën tepër të rëndësishëm këtë libër. Aty gjejmë edhe tematika të shkencave të natyrës.

Analiza e veçorive kryesore tek vepra e Pjetër Bogdanit (Bo/5)¹

1. Fjalë të huajanë nivelin e shprehjes së koncepteve të fushave të dijes i terma: figurë (mat.), konfi (kufi) (fiz.), natyrë (fiz.), shtampë (tek.), avull (fiz.)

2. Fjalë që kanë shërbyer për zëvendësimin e termave të huaj në terminologjitë teknike: dredhë ← spirë, sumbull ↔ buton, kurorë ← koronë, ngarkim ← karikim, kuti ← skatullë, kusht ← konditë.

3. Aktivizimi i prapashtesave -im, -shëm, që vijnë nga Buzuku dhe nga autorë të tjerë: -im: pushim¹- pastrim² - shtim³ - ndërrim⁵ - ngarkim⁵
-shëm: dukshëm⁵, i pakthyeshëm⁵.

4. Folje të ardhura nga emra: armatis ← armë, biroj ← birë, kryqëzoj ← kryq, sharroj ← sharrë.

5. Shtimi i mbiemrave prejpjesorë foljorë:

ngjit → ngjitur, mbështjellë → i mbështjellë, ha → i ngrënë, ngarkoj → i ngarkuar, mbush → i mbushur.

6. Shtimi i vargjeve fjalëformuese:

pastroj → i pastruar → pastrim, fryj → fryrje → i fryrë, shfryj → shfryrje → i shfryrë.

7. Përdorimi i njësive (ndajfoljeve) të formuara me konversion me kalimin emër → ndajfolje, mbiemër → ndajfolje.

kryq-i → kryq (vendos-), rreth-i → rreth (vjen-), i butë → butë (shkel-), i drejtë → drejt (ecën-), i shtrembër → shtrembër (paraqit-).

Përfundim

Gjithçka që arsyetuaam më sipër na bën të hamendësojmë se pjesa më e madhe e leksikut të nxjerrë nga veprat e Lekë Matrëngës, Pjetër Budit, Franga Bardhit dhe Pjetër Bogdanit (si gjallues në kohën e vet, i përshtatshëm, i krijuar) dhe me kuptime të prejardhura (të figurshme, të krijuara me bazë metaforike metonimike, sinekdotike (si armë “arma e së drejtës”, ar “thesar ari”) t’i konsiderojmë si të korrelatuara me kuptimet e drejtpërdrejta, nga të cilat ato mund/duhet të kenë ardhur, si të tilla, duhet të kenë ekzistuar, pra, me formë primare (“armë e së drejtës”) (ar “thesar ari” nga ar si metal i çmuar, të cilat si armë, ar etj.

⁷ K. Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe IV”, “CAMA-PIPA”, Shkodër, 2002, f. 108-388.

Siç shihet mbi këtë bazë janë krijuar kryesisht formimet terminologjike shqipe, krahas formimeve të ardhura nga gjuhët e huaja, si dhe ato të ndërtuara mbi bazën e brumit të shqipes dhe modeleve e tipeve fjalëformuesen (termformuese) të saj, si: boshtor, i rrotullueshëm etj.

Mund të nxirret përfundimi se nga pikëpamja e vendit e përmbajtjes konceptore çdo njësi leksikore e gjuhës identifikohet si fjalë e zakonshme kur bie (ndodhet) në nivelin e ulët, i cili paraqitet si rrafsh i fjalës dhe si njësi e specializuar (fjalë ose togfjalësh), kur ajo funksionon në nivelin e lartë, i cili pranohet edhe si rrafsh i termit. Kjo do të thotë se identiteti i çdo njësie, term ose joterm (d.m.th.) njësi speciale ose njësi jospeciale varet nga rrafshi ku përdoret, ku si parësore është përmbajtja konceptore e jo forma, kur njësia është njëfjalëshe (siç u sollën si shembuj më sipër këmbë (njeriu) (fjalë) dhe këmbë (minerali) (term) ose derë¹ (fjalë e zakonshme) dhe derë² (term në ndërtim) dhe kur njësia është togfjalëshe (dyfjalëshe dhe më tepër), ku përmbajtja konceptore zbulohet nga gjymtyrët e njësisë, p.sh. këmbë e urës, derë rrotulluese etj.

Bibliografia

Ashta, K. (1996): "Leksiku historik i gjuhës shqipe I" (Gjon Buzuku), Universitetit i Shkodrës, "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

Ashta, K. (1998): "Leksiku historik i gjuhës shqipe II" (Lekë Matrënga, Pjetër Budi), Botimet Toena, Tiranë.

Ashta, K. (2000): "Leksiku historik i gjuhës shqipe III" (Pjetër Mazreku, Frang Bardhi), Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

Ashta, K. (2002): "Leksiku historik i gjuhës shqipe IV" (Pjetër Bogdani), Botimet Camaj-Pipa, Shkodër.

Çabej, E. (1971): "Pjetër Budi dhe gjuha e tij" në "Probleme të historisë së gjuhës shqipe", Prishtinë.

Duro, A. (2009): "Termi dhe fjala në gjuhën shqipe (në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes)" QSA IGJL, Tiranë.

Kastrati, J. (2000): "Historia e Albanologjisë", Tiranë.

Kostallari, A. (2016): "Studime në fushën e gjuhës letrare kombëtare", Vëllimi I, ASHSH, Tiranë.

Lafe, E. (2009): "Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar" në "GJENDJA DHE

ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE PROBLEME DHE DETYRA" KONFERENCË SHKENCORE, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë.

Leka, F. (1989): "Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare shqipe" në STUDIME MBI

LESIKUN DHE MBI FORMIMIN E FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE III, ASHSH, Tiranë.

- Mansaku, S. (2018) "Studime për historinë e gjuhës shqipe", Vëllimi II, ASA IGJL, Tiranë.
- Memisha, V. (2002): "Fjalor i termave themelorë të mekanikës" në "GJUHA JONË" nr.3-4, Tiranë.
- Omari, A. (2008): "Kritere të transkriptimit të Cuneus prophetarum" të Pjetër Bogdanit, identifikimi i fonemave zanore" në "STUDIME FILOLOGJIKE", Tiranë.
- Omari, A. (2005): "Pjetër Bogdani" "Cuneus Prophetarius" ("Çeta e Profetëve"), Botim kritik, ASH, Tiranë.
- Pllana, G.(2014): "Standardizimi i terminologjisë së inxhinierisë mekanike në gjuhën shqipe nevojë e kohës", në ALBANOLOGJIA International Journal of Albanology, Vol.1, No:1-2/2014, UDK:81, ISSN 1857-9485 (Print) USHT Tetovë.
- Pllana, G. (2015): "Termet e huazuar nga italishtja dhe frëngjishtja në terminologjinë e mekanikës në gjuhën shqipe" në "KËRKIME GJUHËSORE III" Konferencë shkencore ndërkombëtare, mbajtur më 11 korrik 2014, Tiranë.
- Pllana, G. (2015): "Procese të terminologjizimit në gjuhë" "KËRKIME GJUHËSORE IV" Konferencë shkencore ndërkombëtare, mbajtur më 11 korrik 2015, Tiranë.
- Pllana, G.: Pllana, S.: "Gjendja dhe probleme të zhvillimit të terminologjisë së mekanikës teorike" Seminar i VI-të i Albanologjisë, 20-23 shtator 2012, Tetovë-Shkup 2012.
- Sulejmani, F.: (1979): "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Prishtinë.
- Thomai, J.(2015): "Ligjërata pasuniversitare (leksikologji, semantikë, leksikografi)", UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", Korçë.